



Nr. _____ Prot

Tirane / / 2017

RELACION

**Mbi lënien në fuqi të Vendimeve Nr .139, Nr. 145, Nr.146, Nr. 147,
Nr. 148 datë 26.12.2014 dhe Vendimit Nr.128 datë 29.07.2016
të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017**

BORDIT TË ERE-s

Ne permbushje te pergjegjesive qe i ngarkon Ligji nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ne menyre te vecante referuar nenit 20 gërma c), ERE miraton tarifat për veprimtarite e transmetimit dhe shperndarjes si edhe për ato veprimtari për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik, bazuar në kostot e këtyre shërbimeve.

Vendimi i Bordit të ERE-s nr.190 datë 22.12.2016 la në fuqi tarifat dhe çmimet me pakicë, (te miratuara me Vendimet nr .139, nr. 145, nr.146, nr. 147, nr. 148 datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s) deri në 31.03.2017. Nderkohe më të njëjtin vendim nr.190 datë 22.12.2016 është shtyrë fuqia juridike e Vendimit Nr.128 datë 29.07.2016, me te cilin Bordi i ERE-s miratoi tarifat e shitjes me pakice te energjise elektike per klientet e lidhur ne TM dhe me mates ne TU per periudhen 1 Korrik -31 Dhjetor 2016.

Njekohesisht Bordi i ERE-s me Vendimet nr.191, 192, date 22.12.2016 hapi procedurat per shqyrtimin e aplikimeve te:

- OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2017(22.11.2016)
- OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifave për çdo nivel tensioni për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2017(9.12.2016)

Ne te njejten kohe ne mungese te aplikimeve hapi procedure me iniciativen e vet:

- “Për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH sh.a. për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017”
- Per përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 Prill 2017 – 31 Dhjetor 2017.

Ne zbatim të “*Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*”, përgjate procesit të shqyrtimit të këtyre praktikave, janë kryer veprimet e mëposhtme procedurale:

- Publikimi i aplikimit në faqen zyrtare të ERE-s brenda afatit që përcakton rregullorja duke i kërkuar zyrtarisht edhe shoqërisë OSHEE sh.a dhe OST sh.a të zbatojnë detyrimin për të bërë publikimin nga ana e tyre të aplikimit
- Njoftimi i paleve të interesuara me shkresën nr. 265 prot. Date 30.03.2017 për zhvillim séance degjimore në lidhje me rishikimin e tarifave të përdorimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2017 në kuadër të aplikimit përkatës të OSHEE sh.a.
- Në vazhdim është vijuar me shqyrtimin e aplikimeve si dhe dërgimin nga ana jone të pyetjeve shtese:
 - Shoqërisë OST sh.a., shkresa nr. 34, date 16.01.2017 si dhe shkresa nr. 34/1 me date 23.02.2017 e me tej, vazhduar komunikimi me email në datat 30 e 31 Mars 2017 për informacion plotësues
 - Shoqërisë OSHEE sh.a. me shkresën nr.23 Prot date 13.01.2017 “Kërkese për plotësim dokumentacioni lidhur me aplikimin për përcaktimin e tarifave për çdo nivel tensioni për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2017” dhe në vijim të saj, me nr.23/2 date 28.03.2017, kërkesën me e-mail për informacion plotësues.
 - Shoqërisë KESH sh.a. prej të ciles nuk kishim aplikim për rishikim të cmimit, informacioni i kërkuar me tonen nr. 168 Prot., date 21.02.2017 e me tej, kompania dërgoi informacion me shkresën nr. 635/5, date 27.2.2017
- Marrja e komenteve të paleve të interesuara si Konfindustria, AREA, Albanian Food Industry, Dhoma e Tregëtisë Durrës e cila përfaqësoi në këtë proces edhe dhomat e tjera të tregëtisë të vendit dhe shumë shoqata të tjera të biznesit në Shqipëri.

- Organizim I seances teknike midis paleve te interesuara dhe OSHEE sh.a. ne daten 31.03.2017 ku nga pjesemarresit u diskutuan mjaft ceshtje ne lidhje me tematiken e tarifave te aksesit te propozuara nga OSHEE sh.a.
- Analiza e informacioneve te marra ne lidhje me te ardhurat e kerkuara nga ana e shoqerive.

Analiza ka konsistuar ne krahasimin e te ardhurave te kerkuara te miratuara nga Bordi i ERE-s per vitin 2015 si dhe atyre faktike per kete periudhe, gjithashtu shpenzimet faktike te viti 2016 si dhe ato te priteshme per vitin 2017 sipas aplikimeve dhe informacioneve shtese te derguara nga Kompanite.

Nga keto analiza dhe vleresime te pergjithshme, rezulton se shoqerite KESH sh.a. OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., kane performance te kenaqshme qe pergjithesisht ka mbuluar kostot e veprimtarive te ketyre aktiviteteve pergjate periudhes 2015-2016 si dhe kane krijuar nje rezerve per zhvillimin normal te aktiviteteve per periudhen pasardhese.

Kjo konfirmohet edhe nga rezultati financiar pozitiv, ashtu sic paraqitur ne pasqyrat financiare, per te tre kompanite ne periudhen 2015 – 2016.

Nje ndikim te konsiderueshem ne performancen pozitive te kompanive kane patur:

- Situata e mire hidrike qe ka sjelle nje rritje te gjenerimit te kaskades se Drinit per vitet 2015-2016 me rreth 2,675 GWh energji elektrike, me shume se ai i parashikuar per KESH sha
- Performance positive e shoqerise OSHEE sh.a per periudhen 2015-2016 ne drejtim te uljes se humbjeve ne rrjetin e shperndarjes se energjise elektrike si dhe te arketimit te detyrime te prapambetura

Vlen te permendet se shoqerite, megjithese kane arritur rezultat financiar pozitiv gjate kesaj periudhe, njekohesisht trashegojne detyrime te ndersjellta.

Gjithashtu, edhe per shoqerine OSHEE sh.a. konsiderojme se nder te tjera nje faktor pozitiv ne lidhje me sigurine e te ardhurave te saj per vitin 2017 do te jete arritja e objektive te vendosur nga Qeveria, sidomos reduktimi i metejshem i humbjeve te energjise elektrike ne rrjetin e shperndarjes, si dhe arketimi i te ardhurave nga shitja e energjise elektrike.

Per sa me siper, gjykojme se korrigjimi ne ulje i te ardhurave per keto shoqeri nuk do te ishte i aresyeshem , pasi kjo nuk do te ndihmonte permiresimin financiar te gjithe sektorit dhe vecanerisht ate te OSHEE sh.a, e cila vazhdon te kete nje kapital te vetin negativ prej (rreth -48 miliardë leke)

Nga ana tjeter keto te ardhura mund te perdoren:

- Per **shlyerjen e detyrimeve** ndaj KESH sha dhe OST sh.a.

Per kete qellim OSHEE sh.a. ka ndertuar nje plan te uljes se detyrimeve ndaj KESH dhe OST ne perputhje edhe me ristrukturimin e borxheve te KESH nga EBRD. Sipas kesaj skeme OSHEE do t'i paguaje KESH dhe OST ne 5 vitet e ardhshme rreth 10.7 miliard leke me teper se sa fatura korente duke bere qe borxhi total ndaj KESH dhe OST te ulet ne menyre progressive.

- Per **investime** me qellim uljen e metejshme te humbjeve ne rrjetin e shperndarjes, si dhe permiresimin e cilesise se sherbimit per klientet tarifar, në zbatim kjo edhe të VKM 171 date 25.02.2015

VKM 171 date 25.02.2015, “Per miratimin e Planit te Rimekembjes Financiare te Sektorit te Energjise Elektrike”, vlereson si te disfavorshem raportin e larte te leves financiare. Ndaj orjenton qe:

“cdo lloj financimi i ri duhet te paraqitet si nje forme kapitali i vet dhe vecanerisht ne OSHEE, per te zgjeruar bazen e tij te pronesise dhe evituar projektionet negative financiare te agreguara, per periudhen 2015-2017 dhe reduktimin e impaktit negative nga rritja e tejskajshme e leves financiare ne nje mjedis tejet te paqendrueshem”.

Ne vazhdim, shkresa e MEI me Nr. 682/2, date 03.04.2017, ne cilesine e institucionit pergjegjes per hartimin e politikave te sektorit, me të cilin ERE bashkëpunon në zbatim edhe të parashikimeve të nenit 10 pika 2 të Ligjit 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, vlereson mbajtjen e te njejtut rregjim tarifar per vitin 2017 per te tre kompanite per arsyt:

- *Ministria e Energjise dhe Industrise eshte drejt perfundimit te procesit per berjen efektive te Marreveshjes se Huase mes KESH sh.a. dhe Bankes Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim, per Projektin “Shqiperia, Plani i Ristrukturimit te KESH”, Marreveshja e Garancise ndermjet Republikes se Shqiperise, te perfaqesuar nga Ministria e Financave dhe Bankes Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim, te miratuar nga Kuvendi i Shqiperise, ne menyre qe te garantoje permbushjen e kushteve financiare te prarashikuara, me qellim qe te shmangen kostot financiare shtese.*
- *Nga ana e MEI –t gjithashtu ne bashkepunim me Banken Boterore, po permbyllet procesi i rishikimi te Planit te Rimekembjes se Sektorit te Energjise Elektrike dhe problematika e marredhenieve te ndersjella te kompanive, masa te cilat do te pasqyronin me qarte situaten e permiresuar financiare te sektorit dhe do te reflektonin ne menyre transparente rezultatet e reformave te kryera ne perputhje me kriteret qe percakton ligji dhe objektivat e cituara me sipër. Nevoja per investime mbetet akoma nje imperative per sistemin ne pergjithesi dhe shperndarjes ne vecanti. Nderkaq, prej tashme nje viti sistemi nuk merr me mbeshtetje nga buxheti i shtetit por kontribuon ne te duke shlyer te gjitha detyrimet. Rishikimi i planit synon te permiresoje treguesit target dhe te rrise ne nje nivel cilesor me te larte performancen.*
- *Ne perfundim, mbajtja e sistemit tarifar do mbeshtesë sektorin energjistik nepermjet qendrueshmerise financiare.*

Ne keto rrethana mbi bazen e argumentimit mbi mjaftueshmerine e te ardhurave te shoqerive KESH sh.a., OSTsh.a. dhe OSHEE sh.a. per vazhdimesine normale te veprimtarise se tyre edhe per vitin 2017, i propozojme Bordit te ERE-s:

Propozimi :

1. Shtyrjen deri në 31.12.2017 të fuqisë juridike të pikës 1 të vendimit nr. 190 datë 22.11.2016, të Bordit të ERE për lënien në fuqi të tarifave dhe çmimeve të përkohëshme të energjisë elektrike të miratuara përkatësisht me vendimet :
 - a) Vendimin nr. 139, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015”.
 - b) Vendimin nr.145, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2015”.
 - c) Vendimin nr.146, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015 në nivelin e tensionit 35 kV”.
 - d) Vendimi nr. 147, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës mesatare të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015”.
 - e) Vendimi nr. 148, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.
 - f) Vendimit Nr.128 datë 29.07.2016 “Mbi tarifatat e shitjes me pakicë të energjisë elektrike të lidhur në TM dhe me matës në TU për periudhën 1 Korrik - 31 Dhjetor 2016”.
2. Fuqia Juridike e Vendimit nr.13, datë 16.02.2016 “Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 2016” shteron me marrjen e vendimit për përcaktimin e tarifës fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2017 në zbatim të ligjit 7/2017 “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme”.
3. Shtyrjen deri në 31.12.2017 të fuqisë juridike të pikës 2 të vendimit nr 190 datë 22.11.2016, të Bordit të ERE sa i përket :

a. Për klientet e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV në zbatim të VKM nr. 449 datë 15.06.2016, çmimi i shitjes së energjisë do të jetë 9.5 lekë/kWh ndërsa çmimi në pik do të jetë 10.93 lekë/kWh.

- b. Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV në zbatim të VKM nr. 449 datë 15.06.2016 cmimi i shitjes se energjise do te jete 11 leke/kWh ndersa cmimi ne pik do te jete 12.65 leke/kWh.*
- c. Tarifa e aksesit te shperndarjes per klientet e lidhur ne 20kV te jete 3,9 leke/kWh*